



# LUMO KOLLESHI

## *Lotët e*



## *Nastradinit*



Shtëpia Botuese "FJALET E QIRIRIT"

85H-17  
K 85

LUMO KOLLESHI

LOTET  
E  
NASTRADINIT

(Fabula)

SHTËPIA BOTUESE "FJALËT E QIRIRIT"

57291

PËRMET 2000

Redaktor:

Ylli Hoxha

Kopertina:

Josif Bushi

Grafika:

*Visi*  
designo...•

**SHTËPIA BOTUESE "FJALËT E QIRIRIT"**

Shtypur në Shtypshkronjën "**Stevla**"

## Kusia dhe Kallajxhinjtë

*Një kusi me fundin sterre  
I pat thirur kallajxhinjtë:  
“Do t’ju jap qoftë dhe nderë  
Po më bëtë të florinjtë.”*

*Kallajxhinjtë, siç kanë zakon  
Rrahur në uthull e vaj  
Nëpër dhëmbë diçka thonë:  
“Flori s’kemi veç kallaj,”*

*Dhe kusia mëndjelehtë  
Që veç varet në çengel  
Zbret mes tymit tatëpjete  
“Do bëhem nuse me tel”.*

*Eh, ç’t’i bësh kusisë së gjoreë,  
Flakë e tym e presin prapë  
Kur t’i mbesë fundi në dorë  
Dhe kallaji është bërë baltë.*

## Rrodhet

*E dinë që nuk i mbjell askush,  
Që i shkulin, prapë e dinë.  
Kërcasin si kripa në prush,  
Me çorapet pas të vijnë.*

*Nuk të ndahen këmba-këmbës  
Madje të kërkojnë haraç  
Kur i heq, këcasin dhëmbët  
Dhe helmojnë siq do gjëmbaç.*

## Qeni që nuk vinte mish

*I vetmi qen në stan  
Nuk vuri mish për be  
Dhe ish aq katran,  
Sa s'gjendej përmbi dhe.*

*Kur lëshohej qulli,  
Bishë Kotoja<sup>u</sup> ynë,  
Dhëmbët kujt s'ia nguli,  
Veç t'i vinte synë.*

*Gjysmën e kazanit  
E në mos më tepër.....  
Qentë e tjerë të stanit  
Varnin vetëm veshët.*

*Ujku po të binte  
Për të bëré dasëm,  
Larg Kotoja ikte  
S'kishte punë me vathën.*

*Një ditë zënërimi  
Si rrufe nga retë  
Ju shtrua kurrizi  
Lakror me dyzet petë.*

---

*I. Emër qeni:*

## Nata dhe Dita

*Nata i mbahej dites me te lartë,  
Si t'i falte universit urtësitë:  
“Ti veç një diell ke dhe vetëm kaq,  
Sa yje zbuloj unë për njerëzinë.”*

*Ia ktheu dita me fjalë kursimtare  
Natës që po ngjiste të përpjetën:  
“Yjet që zbulon janë akull fare,  
Ndërsa dielli tokës i jep jetën”.*

## Korbi

*Korbi, nxite dhe më tepër  
Për fatin e bijave të vet,  
Ndaj thirri bojaxhi me emër,  
Pëllumba t'i bënte vërtet.*

*Kur e pyesnin ato dítë:  
“Si të venë zogjtë, o korb?”  
Ai bëhej shend e drithë,  
Më i gazmuari në botë.*

*Ja dhe boja të bën me bojë  
Pas një shtrëngatë me shi,  
Vajti korbi prapë në soj,  
Mbetën zogjtë prapë të zinj.*

## Zog gomari kërkon kalë

*Gomareshën zuri halli,  
Ngulte këmbë zog gomari:  
“Unë do të mbaj veç shalë,  
Përndryshe s’do mbetem gjallë.”  
Opo po ç’u hap një punë!  
Gjithë gomarët pallën vunë:  
“Na, mor bir, ç’të shkrep i koka,  
Do na talle tére bota.  
Gjërat në dynja janë ndare,  
Shala është vetëm pér kalë.”  
Por i biri turfullonte,  
Asnjë gjëmb dhëmbit s’i shkonte.  
Panë ç’panë i thonë doriut,  
ç’t’i bënин mendjeçilimiut?  
Dhe doriu zemrën hapi  
Një shalë të vjetër i zgjati.  
Kërrici hidhej nga gëzimi,  
Por ja erdhi kalërimi  
Edhe gurët e sokakut  
I shkolën zorët prej barkut.*

## Maska në pyll

*Natë e zezë pa hënë e yll,  
U dha alarmi në pyll.  
Mbërritën maskat dhe këtu,  
Pa rrëmbyen gur e dru.  
Ngritën roje në çdo shteg,  
Shqiponja nga qielli ndjek.  
Me pak mund e sakrificë  
Mbaroi dhe aksioni blic.  
U habit vërtet dhe shkëmbi,  
I luajti gurët nga vendi.  
Dhe breshka doli me maska.  
Gjithë pylli ulériu:  
Ujku me maskë njeriu!*

## Pleshti

*Për një plesht, një djallo punë,  
Sherri shkoi në qìell të shtatë  
Dhe jorgani i bukur shumë  
Përfundoi në tym e flakë*

*Porse pleshti veç shikonte,  
Qeshte dhe kérceu përpjetë,  
Një jorgan të ri synonte  
T'ia çonte flakët te retë.*

## Mençuri

*Një ditë, u kapën pas debatit  
Kasapi dhe mentari i fshatit  
“Me kokat që çdo darkë ha unë,  
Patjetër që kam mend më shumë.”*

*Mentari buzagaz i tha:  
“Duhet të shtojë dhe diçka,  
çdo ditë t'i ha koka dhe mish,  
Veçse janë koka bagëtish.”*

## **Filozifi pa tru**

*Një filizof që s'kishte tru?  
Drejt pyllit mori arratinë.  
Të gjorit, njeri iu bë çdo dru  
Dhe u shpaloste filozofinë*

## Zogu i qyqes

*E gënjeu mendja një qyqe  
Një mëngjes të bukur prilli,  
Vajti dhe vendosi vezën  
Në folenë e një bilbili.*

*Priste që zogu i saj  
Si bilbili të këndonte.  
Urrit biri dhe pastaj,  
Lis më lis po fluturonte.*

*Prit një dritë dhe një tjetër  
Të derdhej zëri i bukur,  
Qyqes i therri në zemër  
Edhe zogu bënte “Ku-Ku”.*

## Peshku kërkon doktoratë

*Një peshk i rrahur nëpër valë  
Hyr e dil nëpër provime.  
Pa lexuar asnje fjalë  
Kërkonte nota sublime.*

*Peshku ynë diplomë mori  
Dhe s'e lodhte mendjen fare.  
Gjithë fundin e detit nxorri,  
S'mbeti poshtë asnje korale.*

*“Jam intelektual dhe unë,  
Tha peshku me zë të lartë.  
Siç e nisa këtë punë,  
Do të mbroj dhe doktoratë.”*

## Bretkosat dhe bilbili

*Një pragmbrëmje prilli  
Pranë një kënetë  
Ja filloi bilbili  
Këngës me aq derte.*

*Heshti shpesëria  
Zérin t'i dëgjonte  
Dhe nga melodja  
Qielli yjet zgjonte.*

*Qielli porsi qielli,  
Po ç't'i bësh kënetës?  
Bretkosat i ndezi  
Në korin e tmerrshëm.*

*Bretkosat kërkonin  
Ta mbysnin bilbilin,  
Këngën t'ia ndalonin,  
Ta shurdhonin prillin.*

*Zogu këngëstolisur  
Qeshte nëpër fletë  
Dhe këngën e nisur  
E ngrinte te retë.*

## Dhe breshka...

*Nxorri kokën breshka nga samari  
Dhe kthetrat i nguli fort në tokë.  
Në qiel pa shqiponjën dhe nakari  
Ja fluturoi ato pak mend në kokë.*

*“Vetëm kjo na di të fluturojë?”  
Maramendhi shkoi buzë një greminë.  
U gatit e tha: “Tani jam dhe shqiponjë!”  
Por mbi gurë u bë copë e thërrime.*

## Pjeprit, shalqinit dhe trangullit

*Një pjepër, iu sul shalqinit me fjalë  
Dhe sherri rrëmbeu fushën me bostan.*

*“Paske veshur lëkurë ekologjisti,  
Por brenda ke gjak të kuq komunisti.”*

*Ja priti sakaq shalqini i fryrë  
Dhe gati i hodhi thonjtë në fytyrë.*

*“Të që në lëkurë dukesh, je i prekur,  
Sa të marr pushtetin, të kam për të rrjepur”*

*Nga fjalë u bë një tërkuzë  
Me emra partish me dhëmbë e pa buzë.*

*Trangulli ngriti kokën i alarmuar  
Erdhi si profet për t'i pajtuar.*

*“Të gjithëve një mitër na ka nxjerrë  
Si ju aty në fushë dhe mua në serë”.*

## Padia e karkalecave

*Nuk ishin aspak dordolecë,  
Emrin e kishin karkalecë.*

*Diku në këmbë, diku fluturim,  
Në rrugë të gjatë, por jo në mërgim.*

*Të lodhur, të gjyntuar, tërë plagë  
Në zemrën e drejtësinë arritën, në Hagë.*

*Do pyesë dikush: Në Hagë karkalecë?  
E thamë së pari, nuk ishin dordolecë.*

*Aty na paditën ca agronomë barbarë:  
“Gjenocid i vërtetë s’na lënë as farë!”*

*Dhe gjëja që bëri aq skandal e bujë:  
Armët e tmerrshme: veç pompa me ujë.*

## Gjarpërinxjtë

*Një gjarpër i vogël, i vogël,  
Ju lut njeriut zemërgjere  
Ta fuste në gjirin e ngrohtë.  
Njeriu mëshiroi krijesën e mjerë.*

*Dhe kjo krijesë e çuditëshme  
Po rritej nga dita në dite  
E zezë si nata e frikshme  
Që përbys i kthen perënditë.*

*Kur e mësoi gabimin e bërë  
Njeriu u bë bishë e furtunë,  
Por një natë në netet pa hënë  
Gjarpri e mbyti në gjumë.*

## Ëndërr mizore

*Si erdhi pakëz vërdallë,  
Një mizë mblođhi kuvend.  
Pranë, tenxhere me dhallë  
Gjithë botën la pa mend;*

*“Krahë kam dhe çaj qielin,  
Dëshira nuk më mungon,  
Sot e tutje do kap diellin;  
Sjam më mizë, por avion.”*

*Dhe ashtu mendim ngatërrur  
Ungrit për provën e parë.  
Qielli mbeti pa përshkruar,  
Avioni u zhyt në dhallë.*

## Trokiti portë e ustallarëve

*At e bir dy ustallare  
Ngrinin shtëpitë e fshatit,  
Nam të madh na kishin marrë,  
U qeshte ylli i fatit.*

*Një ditë, kur shiu me rrëke,  
Me vrapim çmendurak,  
Bënte ligjin përmbi dhe,  
I ati zuri shtrat.*

*Trokiti portë e ustallarëve,  
Me ankth e plot ankim,  
S'u gjente radhën fjalëve  
Një plakë për çatinë.*

*E djali mori rrugën  
Siç shkon veriu malit.  
Sa shpejt e mbaroi punën,  
Ungrys vetull e atit.*

*Dhe nisi t'i tregonte  
Për pikën pranë oxhakut,  
Priste që ta ngrohte  
Një fjalë e bardhë e plakut.*

*“Sa ka zanati, bir,  
Eshtë shpellë e vërtetë.  
Mbulove gjithë çatinë.  
Një pikë hape vetë.”*

## Retë dhe mali

*U dyndën hordhitë e reve,  
Donin tē varrosnin malin;  
I zbrazen topat e rrufeve,  
Sulmin e egër nuk e ndalnin.*

*Shiun me kujë derdhën pastaj,  
Po egërsira s'kishte fund,  
Qielli i zymtë nga çdo skaj  
I shtrydh retë e breshër shkund.*

*Kur beteja ra dhe shteri  
E s'e ngiste dot më kalin,  
Habitshëm sytë hapte qielli,  
Në horizont lartohej mali.*

## Çekani dhe mistria

*“Si të dua e gdhend gurin,  
Muret në qiel i ngre përpjetë.  
Ty, për çfarë të të mburrin,  
Për një bisht dhe pér një petë?”*

*Kaç tha çekani mendjengritur  
Dhe përsëri mbi gur qëlloi,  
Por, çuditërisht edhe pa pritur,  
Mistrisë pak llaç na i kërkoi.*

*Si gjithmonë e papërtuar,  
Mëri nuk mbajti e u bind,  
E mori llaçin e gatuar  
Dhe në mur guri u bë plint.*

*Fjalën dot s'e mbajti peng  
I foli qartë e shtruar:  
“Trupin petë e kam vërtet,  
Por mbyll gjithë shëmtitë e tua.”*

## Macja dhe Buçja

*Kishtë rënë macja në hall,  
I lypte buçes një mendim;  
"Një Zot e di si do t'ia dal,  
Kaq matuf sa ky maçoku im!"*

*Gjithë ditën veç lëpin mustaqet,  
M'u nëverit kjo masë tuli.  
Moj motër, po dhe guri çahet,  
Ky as e nxjerr qimen nga qulli."*

*Buçja pa menduar fare,  
Që e kish në majë të hundës;  
"Ka dhe më keq, po dale, dale,  
Mos i rrëzo të gjithë gurët.*

*Kam një unë mavri me bojë  
As mish, as peshk e zerzevul.  
Yti dhe s'mund të shikojë  
Imi i fut vet qimet në qull.*

## Miu doganier

*Një mi e thirrën e i thanë:  
“Ta gjetëm vendin në doganë,  
Tani nuk ka më kontrabandë”.*

*Me furtunë na u nis miu.  
S’ia dilte dot edhe veriu,  
Për një çast dhe deti ngriu.*

*Ditë e parë mbeti, pamend,  
Rregullisht iu vu nderi në vend,  
Kishin frikë të lehnin qentë.*

*Pa kaluar ditë e dytë  
Dhe miut iu hapën sytë,  
Shpejt filloi nga llogaritë.*

*Të priste dhe të vdiste  
Asnjë mace dot s’ë ngiste,  
Por fundi një ditë po vinte.*

*Hodhi sytë përkundruall  
Kërkoi zonë të lirë e truall;  
Dogana e bëri buall.*

## Dy qetë dhe hëna

*Dy qe të etur para një pellgu  
E ndalën vrapin për të pire.  
Argjend i hënës aty që derdhur  
E qetë gati bënë brirët.*

*Pastaj, si pellgun e mbaruan  
Dhe u sheshuan për qetim,  
“E vramë hënën,-kaq menduan,-  
Nuk do të derdhë më ndriçim.”*

*Por, siç ishin ashtu shtrirë,  
Sytë u vanë në kupë të qiellit  
Hëna u përgeshte brirët,  
Përkthente gjuhën e diellit.*

## Lotët e Ketrin

*Një ketrush me pak pellush  
Kërceu nga një gëmushë  
Dhe, ashtu duke u qarë,  
I tha: "Të më ndjesh, moj arrë.  
Ta dish hallin ç'më ka gjetur,  
Në qiell të hapur kam mbetur.  
Do të vijë furtunë e borë,  
Të flas me zemër në dorë,  
Te kjo vrimë që ke nën fletë,  
Më pranon të rri ca net?"  
Nuk e zgjati arra plakë,  
I tha: "Eja të rrimë bashkë."  
Humbi nata nëpër yje,  
Gjumë i rëndë nëpër pyje.  
Ketri doli që nga vrima  
Degë me degë si vetëtima.  
Kërc me thonj e kërc me dhëmbë...  
Zgjohet arra si në gjëmë  
Kur i hodhi sytë përdhe,  
Derdhur kokrrat si rrëke.  
Thirr e thirr, po ku ta gjente,  
Pemë më pemë ketri kërcente.*

## Ujku në gjyq

*Përhumbur mes kolltukut  
Kryetar cjas shterpari  
Pritej fjala e ujkut,  
Në sallë heshtje varri.*

*“E mora vesh dënimin,  
Spendohem për ç’kam bëré,  
Kur frika gjykkon trimin,  
Gjykatës janë të téré.*

*Dënimin kapital,  
Qërruar bëté hesapin.  
A s’është ky skandal,  
Të lirë lini kasapin?*

*Më thoni ç’është një viç?  
Bëhet ka a lopë,  
Kasapi rrjep përditë,  
Unë ha një herë në mot.*

*Tani kam dhe një pyetje  
Për, ju zotërinj cjetë;  
Dënimin me vdekje  
E mban kodi i vjetër?*

*Ju s'njihni kushtetutën,  
Me ç'ligj po më gjykoni?  
Me kodin tuaj të vjetër  
Dhe unë vazhdoj zakonin.”*

## Molla e kuqe

*Një kokërr molle flakë e kuqe  
Tek të tjerët hodhi sytë,  
I dukej vetja porsi nuse  
Dhe përdridhej natë e ditë.*

*Por s'kaloi kohë shumë,  
Krimbi i hyri në palcë.  
Një puhizë fryu mbi lumë,  
Ra kjo kokërr përmbi baltë.*

*Ra në baltë e s'u ngjit kurrë,  
S'erdhi dorë që ta vilte,  
Veç një derr lëshonte shkumë  
Nëpër dhëmbë kur e shtypte.*

## Dhia shterparë

*Një dhi që kurrë s'kishte pjellë  
E s'dinte ç'ish qumështi i gjirit,  
U derdh mbi kecat e mjerë  
Dhe mprehu keq tehët e bririt.*

*Blegërimat aq të njoma  
Nga gjumi ngritën çobanin,  
U vrenjt si në dimër koha,  
Me fener e ndriti stanic.*

*Pa e kapi dhinë shterparë  
Dhe, sa lindi ylli i dritës,  
Mori gurin në kamare  
Dhe mprehu tehët e thikës.*

## Metamorfozë

*Diku në një spital psikiatrik  
Pacientët dolën vrapthi nga dera.  
Një qen aty vjedhur e me frikë,  
Një copë buke rrëmbeu në plehra.*

*U ul pastaj qeni mbi dy këmbë,  
Shikimi flaku tej oborrit.  
Sa filloj mbi gjah të ngulte dhëmbët,  
Një dru i krisi në kurri të gjorit.*

*Upërvaj ulërima me piskamë,  
Kafshata ra mes pluhurit të nxeh të;  
Pacientët u derdhën e u shanë,  
E shqyen kafshatën përsëri qentë.*

## Halli i Nastradinit

*Nastradini rurgë kishte marrë,  
Gomari e ndiqte mbrapa s'i ogic,  
Rruja ishte thikë dhe me shkallë  
Dhe gomari s'po i hipte hiç.*

*Mbushi me duhan llullën e lashtë,  
Këmbëkryq u shtrua te burimi,  
Nga opingat këmbët nxorri jashtë,  
Freskohu dhe qaj Nastradini.*

*Nga pazari kthehej një fshatar,  
Te burimi ndali me një frymë,  
I habitur vallë a kureshtar...  
Pyeti: "Ç'hall e paska zënë efendinë?"*

*"Ah të tatëpjetat e kësaj bote,  
Kur i zbres, si të pushoj së qari?  
Që të marrësh vesh dhe zotërote:  
Të përpjetën të ngjis veten a gomarin?"*

## Tej urtësisë

*Tërëjeta në parmëndë  
Brazda çaj e hap ugar.  
T'i dihej e mira kaut  
Dhe ai do të kishte varr.*

\* \* \*

*Lisi, s'bëhet kurrë rigon,  
Thënë është qysh në lashtësi;  
Madje lisi më mirë pranon  
Të bëhet prush e pastaj hi.*

\* \* \*

*Në kujtesë skalitën të vjetrit:  
Më mirë të dalin sytë se nami.  
Në këtë pikë ashpër proteston Homeri  
Dhe gjithata që sytë duan t'ua marrin.*

\* \* \*

*Në sofrën e të mençurit  
Shtruar dhe kjo fjalë:  
Peshku i madh e ha të voglin  
Dhe vërtet ashtu ka ngjarë.*

\* \* \*

*Mirë i madhi, po i gjori;  
Pse nuk nxë në këtë jetë,  
Për në gojën e padronit  
Rrugën shpesh e marka vetë?*

## Marrshi i Liliputëve

*Ne jemi vërtet liliputë  
Dhe shpirtin e kemi të zi,  
Kudo veprojmë si harbutë  
Gllabërojmë çdo qeveri.*

*Lidhjet i mbajmë me shtetin,  
E vjelim, e shtrydhim, e pimë,  
Në gjak e kemi rryshfetin  
Dhe vet e mallkojmë qeverinë*

*Ca thonë se ne nuk peshojmë  
Aq sa paratë që kemi,  
Këto veç inatin na shtojnë  
Dhe vetes: "O burra!" -i themi.*

*Nuk kemi Krisht e Muhamed,  
Këtu jemivet perëndi.  
Parimi ynë në jetë:  
dollarë, joshje flori!*

*Duam t'i shtypim me këmbë  
Të ndershmit veç na pengojnë.  
Kokëboshët në krye i vëmë  
E punët me ta i mbarojmë.*

## Falli i arixhofkës

*Na ankohej tavolina  
Për të zotin e shtëpisë,  
Në gojë nuk vinte mishëra,  
Pale gotën e rakisë.*

*Në mendime ranë fëmijët,  
S'ishte parë si ky hall,  
Madje dhe gruaja një ditë  
Arixhofkës i desh fall.*

*Pa filloi arixhofka  
T'i këndonte profecinë:  
“Burrit tënd po i zien koka,  
Ti në gojë i zë vakinë.*

*Qejfin mos e bëj qeder  
Po ta them si shpirt, moj xhane,  
Tenderat që burri merr,  
S'kalohen pa lugë të madhe.*

*Eh, kësaj kohe drejtorët  
Rrobëtohen nëpër klube,  
Si t'u bjerë ndër mend, moj motër,  
Në shtëpi për bukë të ulen?”*

## **Qetë në kular**

*“S’jemi më viça si më parë”,  
Ka q thanë qetë rëndë-rëndë.  
Kularin hodhën në qafë,  
U mbërthyen mirë në parmendë.*

*Ja që parmenda ka dhe huqe,  
Hosteni nga mbrapa qëndron;  
Kur këmbët s’i shtyjnë më tutje,  
Mbi vithe shpon e shkallmon.*

*Veç brazdës i binden të mjerët  
E mbushen djersë e jargë,  
Kokën nuk kanë si ta ngrejnjë  
Dhe brirët e tyre i shajnë.*

## Dëllinja dhe Selvia

*Një dëllinjë iu ngrit mendja  
Si erës para stuhisë,  
Fryrë si zonjat e rënda,  
Ikthehet açik selvisë:  
“Ti kërkon të kapësh qielin,  
Le pa le ç’të duket vetja.  
Në varreza ty të mbjellin,  
Poshtë teje jeton vdekja.  
S’ka si unë nëpër brinja,  
Brenda meje fsheh thesare.....”  
I vuri kapak dëllinja,  
Struktur poshtë hijes së madhe.  
Selvia trazoi qielin  
Dhe një e re e shtyu tutje:  
“Me mua lëvdohen njerëzit,  
Kur i nisin vajzat nuse.  
Të të sjellin vetëm sépatën  
Për thesarin tënd të madh.  
Vet e di ku e ke radhën,  
Tek një vrimë në ndonjë gardh.*

## **Miu kërkon paqe**

*Një mi u grind ndër minjtë,  
Sa në kartë nuk thuhen fjalët,  
Iku natës pa lëkurëzinjtë  
E plumbthi i ngjiti shkallët.  
Në vatrën ku digjej kërcuri;  
Gjeti maçokun me mustaqe.  
Sherrin e shtëpisë aty shpuri,  
Në thonjtë e tij e gjeti paqen.*

## Ëndrra e një bajge

*Një bajgë èndërroi të ngjitej në pallat,  
Qiellit i dërgoi një barrë më lutje,  
Kur lutjet nuk arritën atje lart,  
U ngjit në thundrrën e një këpuce.  
Pas këpucës, bajga sqimatare,  
Kërkoi të dilte edhe mbi minare.*

## Një duzinë e ca derrkucë

*Baba derri rëndë-rëndë,  
Ca me feçkë, ca me këmbë  
Dhe, ashtu duke u kruar?  
Hapi portën e shkatërruar.  
Hodhi sytë mbi bijtë derrkucë,  
Llapashitur nëpër llucë.*

*“Qenkan bërë mos o zot,  
S’na u nda balta nga mot.”*

*Pa i mblodhi, i qortoi;  
Vesh më vesh i këshilloi;*

*“Sot e tutje do t’ju ndaj,  
Të mësoni gjuhë të huaj.  
Vendi ynë, vend i ngratë,  
S'bëhet me feçkën lopatë.  
Do vërshojnë donatorë,  
Ne me vrap qeset në dorë.*

*I thamë: Lamtumirë baltë,  
Do të ikim diplomatë.  
Boll na shkoi mundi kot,  
Do të rendim nëpër botë*

*Ti, biro me dy gisht bisht,  
Hidhu vrap për arabisht.  
Ti me feçkën më të gjatë  
Persishten e ke në gjak.”*

*I vështroi dy të parët*

*Lotë gjëzimi nga të qarët.  
Siç shkrep rrufeja nga retë,  
Me një fryshtë derrkuc i tretë:  
“Për mua ç’gjuhë ka mbetur?”  
“Dhe për ty, bir, e kam gjetur,  
Latinishten do mësosh,  
Në Europë kudo të shkosh.”  
Kështu gjithë derrkucët tanë  
Gjuhët botës ia parlanë.  
Gërr andej e vërr këtej  
Ne u mblodhën në koktej.  
“S’ka më pellgie, s’ka më llucë,  
Do jemi doktorë derrkucë.*

*Po çuditën gojëtarët,  
Perënduan shkencëtarët.  
Historianët tërë thinja*

*Do të dridhen mbi mërqinja.  
Pushtetarë e ç'soje kanë  
Baltën tonë do të hanë..... ”*

*Siç dalin kërpudhat me nge,  
Pas një shiu me rrëke,  
Nëpër baltë e nëpër llucë  
Një duzinë e ca derrkucë.  
Pa u futën në kënetë,  
Mbetën veç bishtat përpjetë.*

## Kryetar Mamuthi

*Ka pasur vite të mamuthëve  
Po kohë të tyre s'pati kurre  
I. Kadare*

*Kur po vinte kohë e drithit,  
Në vesh i thanë urithit:  
“Mos u merr tanë me grurin,  
Vrije dhe ti paksa trurin,  
Duhet punë e jo fjalë  
Mamuthin ta bëjmë të parë.”  
Urithi që diten flinte  
Hiletë natës ia dinte.  
Punëve të zeza, siç u dihet,  
Vetëm nata nuk u fshihet.  
Dhe urithi merr ca trima  
Nëpër skuta, nëpër vrima.  
Ja një kosh. U shfaqen minjë  
“Prit-tha trimi, janë të mitë.  
Tungjatjeta, zotërinj!”  
“Ç’zotërinj? S’jemi veç minj.”  
“Tani mblidhni mendtë në kokë,  
Perëndoi fjala “shokë”.  
Ka q gjë e di dhe bufi,*

*Kryetar do bëjmë mamuthin.”  
E mori fjalën i pari  
Që kish mendjen te kryetari.  
“Na duhet dhe vota juaj,  
Boll u tretën për të huaj.  
Me mamuthin kryetar  
Shtohet gruri në hambar.  
Sot e tutje dhe ju minj  
Do të bëhi zotërinj.”  
Rrézuan nga qielli retë,  
Përpara i vunë rrëketë.  
Minjtë, si minj, tjetër s'panë  
Besën më në fund e dhanë.  
Urithi me gjithë trima  
Nuk mbahej si vetëtima,  
Në sy notonte gjëzimi...  
Pse po vonohej votimi?*

*Mamuthi priste, përcëlliste  
Mendjen si lëmsh e vërtiste.  
Futi minjtë në llogari  
Po dini ç'kish vërë vaki?  
Kur dégjoi për zvaranikët,  
Gati sa s'i ra të fikët.  
Mblodhi shtabin e u tha:  
“Të m'i sillni dhe ata.”  
Por dikush s'i vlerësoi,  
Mamuthi për pak qëlloi  
“Nuk fitojmë pa zvaranikët*

*Prishuni mendjen se na fikët. ”*

*Hodhi sytë nga rridhte Nili  
Dhe e ftoi krokodilin  
“Në më do siç të dua,  
Do punosh dhe ti për mua.  
Njëri-tjetrin do të mbajmë,  
Do të jap shpërblim të majmë.  
Do të kem nën veten time,  
Zvaranikët, po m’i binde.”  
Ka q i tha, aspak më shumë.  
Krokodili hop në lumë.  
Vuri kujën krokodili,  
Se ndaloj rrjedhën Nili.  
Kur dëgjuan këtë kujë,  
Zvaranikët bënë bujë.  
Poshtë u derdhën me taborë,  
Zemrat i mbanin në dorë.  
Krokodili këtë deshtë.  
Nën qepalla vetëm qeshte.  
I priti me fjalë të mira,  
Ubë dritë dhe errësira.  
Si anija që gjen bregun,  
Ku e desh e hapi shtegun:  
“Doni të dilni në dete,  
Të hapi ndër kontinente?  
Votën tuaj më premtoni  
Për mamuthin ta lëshoni.”  
Kush i tha qorit për sy*

*Dhe s'pranoi pa një pa dy?  
Krokodilit filloi listën  
Zvarranikët prisnin vizën  
"Do t'i çajmë detet dhe ne,  
Boll ngujim në këtë dhe."*

*Në dritën e shumëpritur  
Mamuthi pak i tronditur.  
Kur gjérat bëhen me votë,  
Të ikën dhe mundi kot,  
Por mendjen s'e la pa vrarë,  
Që të dilte fitimtar":  
"Më sillni këtu dhe pikë  
Veçse minj e zvaranikë.  
Bodiguardët me urgjencë,  
Të shquhen për vigjelencë.  
Pleqtë kanë një mal me mend,  
Sa më shumë në këtë vend.  
Dhe të mos lodhen të shkretët,  
Ju vet t'ua mbushni fletët."  
Kur i madhi të jep urdhër.  
Koka përfundon në hurdhër.  
Siç e thanë, e bënë vërtetë,  
Jehona u mbyt në det.  
Pas pak ulëriti vendi,  
Si një fletë dridhej shkëmbi,  
Venë gurët në kandar  
Mahmuthi u bë kryetar.*

\* \* \*

*Nuk kaloi kohë shumë,  
Sa pak ujë rrodhi në lumë.  
Pllakosi një thatësirë  
Dhe mamuthi me gjithë brirë  
Vendin mbush me ulërima.  
Minjëria i la vrimat;  
“Pikë e zezë, prapë votime,  
Nuk fituam një thërrime.  
Zvarranikët zvarë-zvarë  
Nuk pushonin duke sharë:  
“Na premtuat kontinente,  
Tash na vutë saçin mbi vete”.  
Hapi krahët lajm i zi:  
“Mamuthi sipër tokë u shtri!”  
Gjitha ç’genë me zë kori  
Të gjithë me zë tabori  
“Shejtani mbi ne përmori.”*

## Sherri në shtëpinë e fjalëve

*Na u shtynë e pështynë  
Dhe së bashku me një frymë,  
Ca me gaz e ca me zorr,  
U përplasën në fjalor.  
Djersët si lumi në valë  
Nëpër faqet tërë dhjamë.  
Shoqja shqegen pa në sy,  
Sa rrufe shkrepën aty.*

*“Dëgjoni,-tha parlamenti,-  
Erëzin na mori miletin  
Për një fjalë të mallkuar.  
Sot e tutje do qërruar,  
Ta përzëmë nga kjo shtëpi,  
Na ktheu në herezi.”*

*Aty shto e këtu hiq  
Çfarë u tha, u kthye në ligj.*

*“Halli im éshtë hall mbi hall,  
Kini parë peshkun në zall?  
S’lanë lopatë me baltë  
Pa më hedhur ditë e natë.  
Mendja po më sillet rrrotull,  
Ut treta për këtë popull.  
Qeni, thonë, nuk njeh të zonë,  
Po s’pati para dhe pronë.  
Ndaj dhe ministrat e mi  
Ca për xhep, ca për fisni...  
Mos do rrojnë dymijë vjet,  
Telebingo éshtë kjo jetë.”*

*Kaç tha zonja qeveri  
Telat ranë në qetësi.*

*Por si kolla pas duhanit  
Kérceu në shesh të mejdanit  
Jakënngritur drejtësia,  
Desh t’i ruhej virgjëria:*

*“Gjithë sa janë mes kopesë,  
Më thonë; ja macja e zezë!  
Në doni gjykim nga unë,  
Sot, nesër, s’pret kjo punë,  
Të rrëmbejmë gur e dru,  
Ta degdësim nga këtu,  
Ta na verë nderi në vend,*

*Vëç kjo fjalë po na çmend.*

*Ta mendojmë më së miri,  
Demin ta kapim për briri.  
Kjo fjalë, zonja, zotërinj,  
Ka shëtitur shumë kufij,  
Po tek ne ka ardhur vonë,  
S'qenka fjalë e gjuhës sonë.  
Qënka gogol mbi gogol,  
Ta shesim në interpol.”*

*Dhe u mblodhën kokë më kokë,  
Siç mbledh mal i retë tok,  
Parlamentet qeveritë,  
Si shqatat dhe partitë,  
Brofën me zë oratori:  
“Korrupsion, jashtë nga fjalori!”*

*U deshën, u shtrëmbéruan,  
Brohoritën prapë: “Fituam!”*

*Korrupsioni me mendje plaku  
Hyri prapë nga oxhaku  
“Si nuk paski pakëz cipë?  
U bëtë si gjella pa kripë.*

*Unë jam në shpirtin tuaj,  
Pse më shisni për të huaj?*

*Nuk pret dot spata në blanje,  
Pa mua s'vini dot në banjë.  
Po më nxorrët siç po thoni,  
Vilat vallë ku do t'i çoni?*

*Një fytyrë tjetrën zinte  
Sa dhe miza s'pipëtinte,*

*Gjithsa thanë, i harruan  
Dhe me gaz u përqafuan*

## **PËRMBAJTJA**

Kusia dhe kallajxhinjtë .....	3
Rrodhet .....	4
Qeni që nuk vinte mish .....	5
Nata dhe dita .....	7
Korbi .....	8
Zog gomari kërkon shalë .....	9
Maska në pyll .....	10
Pleshti .....	11
Mençuri .....	12
Filozifi pa tru .....	13
Zogu i qyqes .....	14
Peshku kërkon doktoratë .....	15
Bretkosat dhe bilbili .....	16
Dhe breshka... .....	18
Pjeprit, shalqinit dhe trangulli .....	19
Padia e karkalecave .....	20
Gjarpërinxjtë .....	21
Ëndërr mizore .....	22
Trokiti porta e ustallarëve .....	23
Retë dhe mali .....	25
Çekani dhe mistria .....	26
Macja dhe buçja .....	27
Miu doganier .....	28
Dy qetë dhe hëna .....	29

## LUMO KOLLESHI

---

Lotët e ketrit .....	30
Ujku në gjyq .....	31
Molla e kuqe .....	33
Dhia shterparë .....	34
Metamorfozë .....	35
Halli i Nastradinit .....	36
Tej urtësisë .....	37
Marrshi i liliputëve .....	39
Fall i arixhofkës .....	40
Qetë në kular .....	41
Dëllinja dhe selvia .....	42
Miu kërkon paqe .....	43
Ëndrra e një bajge .....	44
Një duzinë e ca derrkucë .....	45
Kryetar mamuthi .....	48
Sherri në shtëpinë e fjalëve .....	53